

PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

INDUSTRIA MINERARE ID 3.1 GËRMA E

16-Feb-20

VICTORIA INVEST Sh.P.K

PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

QËLLIMI I PROJEKTIT

Shoqëria “Victoria Invest International” sh.p.k. është shoqëri e huaj me seli në Suhareke, Kosovë. Kjo shoqëri ka themeluar në Shqipëri shoqërinë “Victoria Invest” sh.p.k. regjistruar në Q.K.R datë 12.03.2003 dhe pajisur me NIPT K32712206U, me seli në Lagjen “28 Nentori”, Rruga “11 Nëntori”, Elbasan me Administrator të vetëm z. Fatmir KUÇI.

Të dyja shoqëritë ushtrojnë aktivitetet në fushën e Ndërtimit, Pastrimit dhe Gjelbërimit të Sipërfaqeve Urbane, Prodhimit të Materialeve Ndërtimore, Tregetimit dhe Transportit, brenda dhe jashtë vendit etj.

Ato kanë realizuar dhe zbatuar me sukses një sërë projektesh, të cilat kanë ndikuar në rritjen e vazhdueshme të aktivitetit të shoqërive.

Të dyja shoqëritë në Shqipëri kanë realizuar e zbatuar me sukses një sërë projektesh, ku ndër më kryesorët mund të përmendim, ndërtimin e segmentit të Rrugës Kukës-Morinë loti 3 (trase 0-5.85), zgjerimin e këtij segmenti (dublim dhe plotësim), ndërtimin e Rrugës Kuçovë-Belësh-Cërrrik, ndërtimin e rrugës Librazhd – Qafë Stude loti 2 vazhdimi, realizimin e shërbimit të pastrimit të Qytetit të Elbasanit nga viti 2006, realizimin e shërbimit të pastrimit të një prej zonave të qytetit të Tiranës etj. Në Kosovë kanë realizuar mbi 15 projekte të ndërtimit të rrugeve, realizimin rreth 7 kontratave të mirëmbajtjeve dimërore dhe verore të rrugëve të Qarkut të Gjakovës etj.

Përfundimi me sukses i projekteve të mësipërme ka ndikuar në rritjen e vazhdueshme të resurseve financiare të të dy kompanive dhe rritjen e investimeve në të gjitha fushat, sipas objektivit të veprimtarisë së shoqërive.

Investimet e realizuara nga kompania “Victoria Invest Internacional” sh.p.k realizojnë prodhime në përputhje me standartet e BE dhe janë të çertifikuara nga standarti ISO

Grupi i ekspertëve hartues të këtij raporti, kryen mbikqyrjen e veprimtarisë në të gjithë zonën ku zbatohet projekti i paraqitur, duke vlerësuar zbatueshmërinë e këtij projekti. Ato kryen vrojtime të ndryshme edhe ndaj treguesve mjedisor përfshi këtu edhe të biodiversitetit të zonës. Ato zgjedhën dhe zbatuan metodën e listë – kontrollit, e cila vendos nga njera anë të gjithë burimet e mundëshme të ndikimeve negative në mjedis dhe nga ana tjetër, bartësit e këtyre ndikimeve si dhe parashikimin e madhësisë së çdo njerit prej ndikimeve të identifikuar.

Vlerësimi i ekspertëve përkatës është se kemi të bëjmë me zbatim përgjithësisht korrekt të projekteve të ndërtimit dhe instalimit të linjës teknologjike të prodhimit të betoneve, duke treguar një menaxhim të qëndrueshëm të saj. Me zhvillim të qëndrueshëm duhet të kuptojmë kontrollin e ndotjes, përdorimin eficient të energjive të përdorura, menaxhimin e mbetjeve teknologjike, parandalimin e aksidenteve mjedisore dhe të atyre në punën e shfrytëzimit të kësaj linje teknologjike etj.

Raporti i paraqitur në vijim synon të japë një informacion të detajuar dhe të besueshëm lidhur me ndikimin në mjedisin e zonës ku punohet dhe më gjërë rreth saj, të projektit të propozuar për zbatim në:

- përdorimin e tokës dhe ndikimet në të,

PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

- ndikimet në florën dhe faunën,
- ndikimet në ujrat sipërfaqësore dhe ato nëntoksore, burimet e ujit, etj.
- ndikimet në ajër nga shkarkimet e gazeve të ndryshëm dhe të pluhurit.
- ndikime në infrastrukturën e zonës.
- ndotjen akustike.
- çdo ndikim social-ekonomik të mundëshëm.

Pjesë e rëndësishme e këtij raporti është parashikimin dhe përshkrimi i masave zbutese të ndikimeve të identifikuar dhe të analizuara të projektit të paraqitur me qëllim, eliminimin ose/apo zvogëlimin e efekteve negative në mjedis nga shkarkimet e identifikuar me synim përmisimin e cilësisë dhe të qëndrueshmërisë së mjedisit nëpërmjet:

- ❖ Shqyrtimit të alternativave të ndryshme të zbatueshme brenda fushës së veprimtarisë së projektit të paraqitur.
- ❖ Analizës së faktorëve pozitivë dhe të atyre negative me ndikim në mjedis, duke dhënë rekomandimet përkatëse, zbatimi i të cilave bën të mundur reduktimin ose/apo eliminim e këtyre ndikimeve negative.

VENDNDODHJA E VEPRIMTARISË.

Linja teknologjike e prodhimit të betonit të markave të ndryshme, është në shërbim të punimeve ndërtimore për segmentin rrugor që ndërton Subjekti VIKTORIA INVEST , si pjesë e rrugës Qukës – Qafë e Plloçës. Projekti i ndërtimit të rrugës Qukës – Qafë e Plloçës, është pjesë e koridorit rrugor Tiranë – Korçë (Koridori VIII), që konsiston në ndërtimin e një segmenti rrugor prej 43.4 km i gjatë, që do të kalojë ndërmjet Qarkut të Elbasanit dhe atij të Korçës e që së bashku me ndërtimin e rrugës Tiranë – Elbasan, do të sigurojë një lidhje të qëndrueshme dhe komode midis portit të Durrësit e vendeve të tjera të Ballkanit, si Maqedonia e Veriut, Greqia, Bullgaria, Turqia etj. duke e bërë Shqipërinë vendin më të përshtatshëm për të kryer tranzitin nga vendet e Ballkanit drejt Europës dhe anasjelltas.

Kjo rrugë shërben gjithashtu, si bajpas për qytetin e Pogradecit, një nga kryeveprat turistike të Shqipërisë Jug-Lindore, duke shmangur kështu ndotjen e qytetit dhe të liqenit të tij si pasojë e tranzitit të mjeteve të rënda, e cila do të rrisë komoditetin turistik në këtë rajon dhe, për pasojë, do të sjellë rritjen e numërit të turistëve.

Kjo rrugë që kalon në zonën e Mokrës krijon akses me tregjet e Korçës, Pogradecit, Librazhdit, Elbasanit apo edhe më gjërë dhe do të sjellë investime të reja në bujqësi, rritje të konsiderueshme të prodhimit vendas dhe, për pasojë, uljen të konsiderueshme të papunësisë.

Gjatësia e segmentit rrugor Qukës – Qafë e Plloçës është 43.4 km, rruga në 10 km e para kalon përgjatë lumit Shkumbin e më pas vazhdon në malësinë e Mokrës, e cila njihet si një zonë me terren të vështirë dhe për këtë arsye do të ndërtohet një numër i madh muresh mbajtës dhe pritës, më shumë se 20 ura dhe viadokte si dhe një tunel 375 metra i gjatë. Rruga do të ketë një gjërësi prej 12 m, me dy krosi me gjërësi 3.75m sejcila (7,5 m në total),

PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

dy bankina të asfaltuara, me gjërësi 1.5 metra sejcila dhe, dy bankina të paasfaltuara, me gjërësi 1 m sejcila.

Objekti në të cilin zhvillohet veprimtari e prodhimit të betonit gjendet në teritorin e Fshatit Slabinjë të Njesisë Administrative Proptisht të Bashkisë Pogradec. Kemi të bëjmë me një zonë tërësisht rurale, e cila mbështet kryesisht në zhvillimin bujqësor të fermave familjare të banorëve të zonës. Është një teritor pothuajse kodrinor, që gjendet në pjesën jug-lindore të vendit tonë.



Trualli mbi të cilin zhvillohet kjo veprimtari nuk ka asnjë lloj funksioni apo përdorimi veç atij në shërbim të kësaj veprimtarije. Ai karakterizohet nga një sipërfaqe pothuajse e çveshur nga bimësia. Në të, nuk ka asnjë element infrastrukture, kjo edhe për faktin se është larg qendrës së banuar, mungesës së burimeve ujore, është jashtë planeve të pushtetit për ndërtimin e infrastrukurës dhe elementëve të saj.

Objekti gjendet rreth 200 metra larg nga rruga kombëtare Qukës – Qafë e Ploçës.

i. Të dhëna të përgjithëshme.

Objekti në të cilin zhvillohet veprimtari e prodhimit të betonit gjendet në teritorin e Fshatit Slabinjë të Njesisë Administrative Propisht të Bashkisë Pogradec. Kemi të bëjmë me një zonë tërësisht rurale, e cila mbështet kryesisht në zhvillimin bujqësor të fermave familjare të banorëve të zonës. Është një teritor pothuajse kodrinor, që gjendet në pjesën jug-lindore të vendit tonë.

Bashkia e Pogradecit bën pjesë në prefekturën e Korçës. Territori i administruar prej saj ka një sipërfaqe prej 548 km² dhe, kufizohet:


- në veri me bashkinë Prrenjas,
- në lindje me Republikën e Maqedonisë,

PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

- në juglindje me bashkinë Pustec,
- në jug me bashkinë Maliq,
- në perëndim me bashkinë Gramsh,

Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Pogradecit.

Kjo bashki përbëhet nga 8 njësi administrative, të cilat janë: Pogradec, Udënisht, Buçimas, Çerravë, Dardhas, Trebinjë, Proptisht dhe Velçan. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Pogradecit dhe qarkut të Korçës. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 72 fshatra.



Fshatrat; Proptisht, Rodokal Sipër, Rodokal Poshtë, Homezh, Slabinjë, Somotinë, Kriçkovë, Selcë e Poshtme, Homçan, Vërri, Golik, Slatinë, Baribardhë, Selishtë, Zalltore Banorët i janë përshtatur relievit malor dhe mbijetojnë me vështirësi, çka i detyron të gjejnë zgjidhje tek pyjet ose tek minierat e braktisura.

Pothuajse gjysma e zonave që tashmë do të kenë si qendër qytetin liqenor, kanë mungesa të theksuara të infrastrukturës ndërlidhëse me Pogradecin dhe jo rrallë izolohen nga dëborat gjatë muajve të dimrit, çka identifikohet si një sfidë e mundshme lidhur me marrjen dhe aksesin e shërbimeve që do të ofrohen në nivel bashkie.

Njësia Administrative Proptisht, përbëhet nga 15 fshatra: Proptisht, Homçan, Kriçkovë, Selcë Poshtë, Homezh, Rodokal i Sipërm, Rodokal i Poshtëm, Zall-Torre, Golik, Vërri, Slatinë, Selishtë, Baribardhë me rreth 6390 banorë / 1938 familje

Territori i kësaj njësie administrative zë një sipërfaqe prej 7500 ha dhe përfshin një pjesë të zonës së Mokrës së Poshtme. Mokra e Sipërme me Mokrën e Poshtme kanë disa të përbashkëta por edhe dallime, si në folklor, veshje popullore e në të folur.

Zona ka shumë elemente tërheqëse për turistët shqiptarë e të huaj, të natyrës peizazhiste, arkitektonike e historike.



Varret monumentale të Selcës, të gdhendura në gur, ndodhen në kodrën e Gradishtës të Selcës, në pjesën perëndimore të fshatit të sotëm Selcë e Poshtme.

Pranë fshatit Slabinjë ndodhet një urë e vjetër (degë e rrugës Egnatia, e përmendur edhe më sipër), Ura e Golikut, vazhdim i rrugës Egnatia, Ura e Terziut vazhdim i rrugës Egnatia, rrapi i Rodokalit 300-vjecar, Gurët e Nuses) e cila vazhdontë në fshatrat Shpellë, Llëngë, Niçë deri në Voskopojë.

Kërkesa për ndërtim, kryesisht banesash janë të shumta (në tokat e tyre) Megjithatë është ndërtuar edhe pa leje. Ndër problemet më imediate, zgjidhja e të cilëve do të sillte përmirësime të ndjeshme në jetën e banorëve, veçohen: - Rrjeti i furnizimit me ujë të pijshëm - Rikonstruksioni i kanaleve vaditëse për bujqësinë, investim që do të zgjidhte vaditjen e tokave bujqësore. - Sistemimi i rrugëve ekzistuese dhe nyjet lidhese me aksin e ri rrugor Qukes –Qafë Plloçë - Sistemimi i ujrave të zeza e të bardha brenda fshatrave dhe paisja me matesa për ujin e pijshëm.

ii. Përshkrim i përgjithshëm i gjeologjisë të zonës.

Gjeohapësira e bashkisë Pogradec përbëhet nga disa elementë të relievit si: Fushëgropa e Pogradecit, Krahina e Mokrës, Malësia e Gorës, Kurrizi malor: Maja e Beshenikut – Qafë Thanë, Gjeohapësira kodrinoro- malore: Dardhas- Alarup dhe qyteti i Pogradecit.

Qyteti i Pogradecit shtrihet në vijën bregore në jug të liqenit të Ohrit, i vendosur përgjatë kodrave në formën e një teatri, shkallaret e të cilit zbresin drejt liqenit. Ka një pozicion fushor në lartësinë 694 m mbi nivelin e detit. Në veriperëndim, Pogradeci zotërohet me pamje e vëzhgim të relievit prej një kodre me lartësi rreth 800 m, ku ka qenë edhe një qendër banimi e hershme e Dasaretisë (Enkelana). Në juglindje vijon me fushën e Starovës, pas së cilës vijon sistemi kodrinor rrethues jugor, për gjithë rrethinën e tij.

Qyteti është i vendosur prej shekujsh në të ashtuquajturën Gropa e Pogradecit e cila zë pjesën jugore e jugperëndimore të gropës së Ohrit. Gropa e Ohrit, nga pikpamja gjenetike bën pjesë në zinxhirin e gropave tektonike. Aktualisht ajo ulet me një amplitudë deri në 2-3 mm/vit.

a) Në zonën e Pogradecit janë të pranishme llojet e formacioneve shkëmbore si ato karbonate, magmatike dhe poroze.

PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

Formacionet e karbonateve përfaqësohen nga gurët qëlqerorë dhe dolomitet, të cilat janë të pasura me faunën e çdo epoke. Formacionet e flishit janë të pranishme në këtë zonë, por jo të shpërndara gjerësisht. Formacionet karbonatet janë të pranishme në formacione të tjera si shiste argjilore, konglomerate, gurë qëlqerorë silicorë dhe argjilë. Këto formacione mbulohen nga një shtresë bimësie që arrin nga 0.2-0.5m në disa metra në vendet ku këtë e lejon ndërtimi gjeomorfologjik. Shpërndarja e tyre në zonë nuk është uniforme.

Formacionet magmatike përfaqësohen kryesisht nga shkëmbinjtë ofiolite dhe vullkanosedimanetare. Ato zënë një sipërfaqe të konsiderueshme të zonës. Trashësia e shtresave tokësore të bimësisë mbi këto formacione është zakonisht nga 0.5-1.5 m për shkak të mungesës së pyjeve dhe pjerrësisë së madhe të shpateve. Shpërndarja e tyre në zonë nuk është uniforme.

Formacionet poroze (Kuaternari-K). Këto formacione përfaqësohen kryesisht nga sedimentet aluviale-proluviale të liqenit, si rëra, zhavorri, llumi dhe sedimentimet fluvio-glaciale si rëra, zhavorri dhe llum. Ato janë të shpërndara në të gjithë zonën në formën e aluvioneve, proluvioneve dhe deluvioneve. Trashësia e tyre në qendër të zonës arrin në 50-60m.

b) Ndërtimi gjeologjik i Gropës së Ohrit/Pogradecit.

Liqeni i Ohrit/Pogradecit ka origjinë tektonike dhe, i përket periudhës gjeologjike terciare si pak liqene të tjerë në botë. Vetë liqeni i Ohrit/Pogradecit është i formuar mbi një strukturë me orientim meridianor dhe shtyrje horizontale përgjatë lidhjes kryesore ndarëse tektonike: Bilisht – Korçë – Dibër. Forcat tektonike kanë formuar një pjesë të konsiderueshme të terrenit të pellgut ujëmbledhës të këtij liqeni. Struktura e shtratit shkëmbor të zonës së pellgut ujëmbledhës përfshin shkëmbinj të llojeve, përbërjeve dhe moshave të ndryshme, kryesisht shkëmbinj metamorfik paleozoik dhe magmatik. Përbërjet mezoike datojnë qysh në Triasik dhe kanë dy lloj faqesh: sedimente konglomerate karstike, rërë, argjilë dhe sedimente karbonatike si gurë rrasash, depozita qymyri, gur qëlqeror dhe dolomite, duke krijuar rrugë kalimi për ujin nëntokësor mes pjesëve të konsiderueshme të Malit të Thatë. Sedimentet cenozoike përbëhen nga shtresa të Pliocenit dhe Kuaternarit. Sedimentet e Pliocenit gjenden në pjesën veriore dhe perëndimore të Luginës së Prespës.

c) Ndërtimi gjeologjik i pellgut të Shkumbinit.

Pellgu i lumit Shkumbin, shtrihet tërësisht në zonën e mesme të Shqipërisë. Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës të këtij lumi është 2445 km², lartësia mesatare e pellgut rezulton 753 metra, gjatësia e tij 181 km, pjerrësia mesatare e pellgut 300/00.

Formacionet gjeologjike që ndërtojnë pellgun e Shkumbinit, përbëhen, si nga llojet sedimentare ashtu edhe nga ato magmatike e metamorfike. Shkëmbinjtë sedimentarë përfaqësohen nga:

- Evaporitet e Permo-Triasit të Dumresë.
- Depozitimet e Triasikut të Mesëm (qëlqerorë të kuq, silicorë të kuq, qëlqerorë pllakore me silicorë të facies pellagjike).
- Seria vullkanogjeno-sedimentare e Triasikut të Mesëm-Jurasikut të Poshtëm.

PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

- Gëlqerorët shtresëtrashë të Triasikut të Sipërm-Jurasikut të Poshtëm.
- Gëqerorët e kuqërremtë të Jurasikut të Mesëm.
- Pakoja argjilite copëzore, pakoja konglobrekçioze ofiolitike dhe flishi gëlqeroro-mergelor i Jurasikut të Sipërm-Kretakut të Poshtëm.
- Gëlqerorët, gëlqerorët konglomeratike, konglomeratet dhe rreshpet argjilo-silicore të Kretakut të Poshtëm.
- Depozitimet e Kretakut të Poshtëm-Sipërm (ndërthurje flishoidale të gëlqeroreve, mergeleve, ranoreve dhe argjilave).
- Dolomitet dhe gëlqerorët dolomitikë të Kretakut të Sipërm.
- Depozitimet flishore të Kretë-Paleogjenit (ndërthurje argjilash, alevrolitesh, mergelesh, gëlqerorësh mergelorë dhe ranorësh).
- Depozitimet e Paleogjenit (gëlqerorë, flishi ritëmholle argjilo-alevrolitor me breza ranorësh dhe gëlqerorësh pelitike, pako copëzore ofiolitike, flishi ranoro-alevrito-argjilor, flishi ritëmmesëmtrashë ranoro-argjilor dhe flish ritëmholle argjiloalevrolitor, flishi ranoro-konglomeratik).
- Depozitimet e Miocenit (ranorë, konglomerate, argjila, alevrolite, mergele gëlqerorë litotamnikë).
- Depozitimet e Pliocenit (konglomerate bazale, ndërthurje ranorësh e alevrolitesh të suitës Helmësi, konglomerate dhe ranore të suitës Rrogozhina).
- Depozitimet e shkriфта të Kuaternarit, si ato të Pleistocenit ashtu edhe ato të Holocenit. Këto të fundit përbëjnë aluvionet që ndërtojnë shtratin e Shkumbinit dhe terracën e parë të tij.

Shkëmbinjtë magmatikë dhe metamorfikë përfaqësohen nga:

- Vullkanitet e Triasikut të Mesëm dhe të serisë vullkanogjeno-sedimentare (T2-J1) (diabaze e mikrodibaze, variolite e mikrovariolite, porfirite diabazike, hialobazalte).
- Mesëm (harcburgite, dunite, lercolite dhe llojet e tyre plagjioklazike).
- Shkëmbinjtë metamorfikë (rreshpe amfibolitike, epidotike, kuarc-mikore dhe serpentinite)

d) Përshkrimi i sizmicitetit të zonës së projektit.

Studimet sizmoteknike kanë të bëjnë me të dhënat për termetet. Ato, lidhin sizmicitetin me shkëputjet aktive. Kushtet e vendosjes strukturore dhe tektonike të ndodhjes së termeteve janë përfutuar kryesisht nga analiza përgjithësuese e të dhënave nga gjeologjia, gjeofizika dhe dukuritë sizmologjike. Është e njohur se, aktiviteti i sotëm tërmetor lidhet ngushtë me strukturën gjeologjike dhe atë neotektonike të vendit tonë. Është gjithashtu e njohur dhe e pranuar se, shkëputjet tektonike janë burimet e çlirimit të energjisë sizmike.

iii. Përshkrim të faktorëve klimatikë.

Sipas vendosjes gjeografike, objekti ndodhet në zonën e klimës tranzitore, në zonën klimatike mesdhetare kodrinore nënzona jugperëndimore që shtrihet deri në 800-1000 m mbi nivelin e detit dhe në zonën klimatike mesdhetare malore nënzona juglindore pjesa e sipërme e relievit deri në lartësinë 2373 m. Pozicioni gjeografik, mbizotërimi i kodrave dhe maleve bën që territori i bashkisë së Pogradecit të futet në zonën e tipit kontinental lokal ku dimri është i ftohtë dhe me rreshje jo të shumta dhe, vera e freskët dhe e thatë.

PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

Temperaturat mesatare mujore luhatet nga 20 deri në 24 °C. Temperaturat maksimale gjatë verës variojnë 20-30 °C me një mesatare rreth 21 °C në Korrik dhe maksimumi arrin në Gusht me 34 °C. Temperatura mesatare me e ulët është gjatë Janarit me rreth 1.5 °C, me një minimum prej -17 °C.

Reshjet janë një prej faktorëve kryesorë që influencojnë në regjimin klimaterik të zonës. Reshjet e shiut variojnë gjatë vitit dhe luajnë një rol të rëndësishëm në balancën e ujit të pellgut ujëmbledhës të kësaj zone. Niveli më i lartë i reshjeve shënohet në periudhën Nëntor- Janar si dhe në pranverën e vonë, zakonisht në Maj. Reshjet, arrijnë nivelin më të ulët gjatë Korrikut dhe Gushtit. Reshjet mesatare të shiut në vit arrijnë afërsisht 759 mm.

Gjatë dimrit në këtë rajon, bien edhe reshje dëbore, trashësia e të cilës shkon zakonisht mbi 0.5m, ndërsa në lartësitë e mëdha, trashësia e dëborës shkon deri në mbi 1m. Dëbora fillon të bjerë që në fundin e muajit Nëntor dhe vazhdon në mënyrë jo të qëndrueshme deri në muajin Shkurt.

Ky territor, pothuajse gjatë gjithë vitit, por veçanërisht në periudhën fundi i vjeshtës-fillimi i pranverës rrihet nga erëra të ftohta. Era më e shpeshtë është ajo që fryn nga veriu, sidomos në vjeshtë dhe në dimër. Ererat që fryjnë nga jugu dhe juglindja dominojnë gjatë pranverës dhe verës. Ererat e juglindjes dhe lindjes janë të konsiderueshme.

Periudhat e qeta dhe me erë ndryshojnë gjatë ditës, veçanërisht në verë. Mëngjeset karakterisohen nga luhatjet mes erërave që fryjnë nga veriu dhe periudhave të qeta. Kushtet e motit ndryshojnë mjaft pasditeve, kur fillojnë ererat e jugut dhe juglindjes. Shpejtësia mesatare e erës në rajon është relativisht e ulët rreth 3.0 m/sek

iv. Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore në zonën e projektit.

Rrethi i Pogradecit ka një hidrografi të pasur si me ujëra sipërfaqësore ashtu edhe nëntokësore, edhe pse burimet aktive gjithëvjetore janë të dendura vetëm nga lartësitë 800 m mbi nivelin e detit, ndërsa në zonën e poshtme ato janë të rralla.

Burimi ujqor më i rëndësishëm i kësaj zone/rajoni është LUMI I SHKUMBINIT

Pellgu i lumit Shkumbin, shtrihet tërësisht në zonën e mesme të Shqipërisë. Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës të këtij lumi është 2445 km², lartësia mesatare e pellgut rezulton 753,2m, gjatësia e tij 181,4km, pjerrësia mesatare e pellgut 300/00, dendësia e rrjetit hidrografik 1,9km/km². Prurja mesatare shumëvjeçare e aluvioneve pezull është 187kg/sek, kurse turbullira 3040gr/m². Mineralizimi është 317mg/l dhe përbëhet kryesisht nga bikarbonate. Prurja shumëvjeçare e Shkumbinit në derdhje është 61,5m³/sek që i përgjigjet një moduli prej 25,2m³/s/km². Koeficienti i rrjedhjes për të gjithë pellgun hidrografik është 0,59, moduli i rrjedhjes së aluvioneve pezull 2373 ton/km² në vit. Ushqimi sipërfaqësor i Shkumbinit përfaqëson 61% të rrjedhjes vjetore, ndërsa ai nëntokësor 39%.

Sipas rajonizimit klimatik të Shqipërisë, lugina e Shkumbinit, nga burimet ujore në drejtim të detit, përfshihet pjesërisht në nënzonën juglindore të Zonës mesdhetare malore, pjesërisht në nënzonën jugore të Zonës Mesdhetare paramalore, në nënzonën juglindore të Zonës mesdhetare kodrinore dhe së fundmi në nënzonën qëndrore të Zonës mesdhetare fushore, e cila zë dhe pjesën më të madhe të këtij rajoni. Rreshjet lëkunden nga 650-1700 mm dhe

PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

numri i ditëve me rreshje lëviz ndërmjet 85-120 ditëve. Temperatura mesatare vjetore lëviz nga 3-60 C në 15-160 C. Në pjesën e sipërme të luginës së Shkumbinit, pasuritë ujore janë të mëdha. Ato përfaqësohen nga vetë lumi i Shkumbinit, degët e shumta të tij dhe burimet karstike. Prurjet ujore dallohen për pjerrësi të lartë të pellgjeve ujëmbledhëse dhe për mbulesë të pakët bimore. Në këto kushte ato dallohen për vlera të larta të prurjeve të lëngëta dhe të ngurta sidomos në stinën e pranverës. Burimet më të shumta takohen në krahun e majtë të luginës, në kontaktin tektonik të gëlqerorëve me molasat dhe magmatikët.

v. Përshkrimi i biodiversitetit në zonën e projektit.

Termi biodiversitet është shumë kompleks dhe si i tillë, zhvillimi dhe përcaktimi i strategjive të përshtatëshme për mbrojtjen e tij, shoqërohet me një proces të vështirë zgjedhjesh dhe vendimmarrjesh. Biodiversiteti përbën terësinë e llojeve dhe ekosistemeve në një rajon. Cënimi i tyre, si rezultat i aktiviteteve të ndryshme ekonomike përbën një shqetësim të përgjithshëm. Në aspektin ekologjik, larmia biologjike, flora dhe fauna në terësinë e saj në këtë zonë paraqet një pamje të një larmie në të cilën mbizoterojnë zona përgjithësisht të zhveshura, me bimësi të ulët, shkurre makjet mesdhetare si mare, mersinë, shqopë, prall, xanë, gjeneshër, shkozë, mrete etj. Ka pak zona me dushke dhe përgjithësisht mungojnë pyjet e larta.

a. Bimësia.

Prania e llojeve të ndryshme të tokave si dhe kushtet klimaterike, kanë kushtëzuar edhe zhvillimin e bimësisë, si atë natyrore dhe atë të kultivuar.

Familjet fshatare kanë në pronësi një sasi relativisht të vogël tokë arë, sasi kjo e pamjaftueshme për zhvillimin e një ekonomie bujqësore me kërkesat e ekonomisë së tregut. Infrastruktura në mjediset rurale në shërbim të bujqësisë është relativisht e keqe, Në Mokrën e Sipërme, janë shkatërruar dy rezervuarët e Mujazës, njëri me kapacitet 5 milion metër kub ujë, ndërsa tjetri me 3.5 milion metra kub ujë.

Ndër kulturat e drithërave gruri zë peshën specifike më të madhe, rreth 35 % të sipërfaqes së mbjellë me bimë arësh. Me misër mbillet rreth 21 % e sipërfaqes që zënë drithërat e bukës. Pësia specifike e misrit për prodhim buke po vjen duke rënë çdo vit. Ai më gjërë përdoret si ushqim për blegtorinë.

Kushtet klimatike favorizojnë kultivimin e një numëri të konsiderueshëm llojesh perimesh, si patatja, fasulja, domatja, qepa, kastravec, speci, hudhra, kungulli, lakra, e deri te erëzat e ndryshme. Zona ka tradita edhe në pemëtari e vreshtari. Kështu përmendim kultivimin e rrushit, mollës, dardhat, kumbullat, arrat, gështenjat, ullirin, etj.

b. Fauna e zonës.

Veshja bimore, kushtet klimatike, si dhe karakteristikat e tokave, vlerësohen relativisht të përshtatshme për zhvillimin e një faune të pasur të kësaj zone. Administrimi i faunës ekzistuese, mbetet aktivitet në duart e pakontrolluara dhe spontane me rezultate të

PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

pafavorshme për këtë pjesë të botës së gjallë të territorit të kësaj zone në të cilën takohen ujku, dhelpira, baldosa, nuselalja, lepuri etj
Kushtet natyrale të relievit krijojnë mundësi për mbarështimin e blegtorisë, veçanërisht të deles e të dhisë, por edhe të gjedhit e të një thundrakëve. Këtu rriten edhe mjaft shpendë të butë kryesisht pulat.

vi. Cilësia e ajrit në zonë.

Njësia Administrative Propisht dhe në përbërje të saj fshati Slabinjë, shtrihen në një teritor tërësisht rural, në të cilin nuk janë të instaluar linja teknologjike gjatë veprimtarive të të cilave mund të ketë shkarkime të gazeve e pluhurave.

Punimet për ndërtimin e rrugës Qukës – Qafa e Plloçës, kanë ndikuar në cilësinë e ajrit të zonës, cilësi e të cilit është ndikuar nga shkarkime të gazeve dhe veçanërisht e pluhurave.

Në këtë zonë ushtrohen veprimtari të veçanta të karakterit të shërbimeve si pika karburanti, bare e restaurante, servis makinash etj.

Në tërësi kjo zonë duhet vlerësuar si një zonë rurale me, tregues cilësorë përgjithësisht normal të ajrit, ujrave siparfaqësore dhe ndotjes së tokës.

Në Raportin e Gjendjes së Mjedisit për vitin 2018, pasqyruar në faqen zyrtare të AKM-së, nuk paraqiten të dhëna zyrtare mbi cilësinë e ajrit, ujrave dhe të tokës si dhe tregues të tjerë mjedisor për Rrethin e Pogradecit, teritor i cili përfshin edhe fshatin Slabinjë në të cilin ushtrohet ky aktivitet.

vii. Niveli i zhurmave në zonë.

Në lidhje me nivelin e gjenerimit të zhurmave, duhet të tregojmë të njëjtat vlerësime si më lart. Kemi të bëjmë me një zonë pothuajse me zhvillim bujqësor dhe me pak veprimtari të linjave prodhuese dhe të shërbimeve të ndryshme. Zhurmat e pranishme janë me periodicitet të përkohëshëm të shkaktuara përgjithësisht nga lëvizja apo puna e mjeteve bujqësore dhe ato të transportit.

Niveli i zhurmave ndikohet negativisht gjatë orare të punimeve që kryhen për ndërtimin e rrugës Qukës – Qafa e Plloçës.

Në Raportin e Gjendjes së Mjedisit për vitin 2018, pasqyruar në faqen zyrtare të AKM-së, nuk paraqiten të dhëna zyrtare mbi nivelin e zhurmave për Rrethin e Pogradecit, teritor i cili përfshin edhe fshatin Slabinjë në të cilin ushtrohet ky aktivitet.

viii. Administrimi i mbetjeve në zonën e projekti.

Bashkia Pogradec ka të organizuar shërbimin e largimit të mbetjeve urbane nga qendrat e banuara në një venddepozitimi të tyre. Ky shërbim nuk shtrihet në teritorin e administruar nga Njësia Administrative Propisht.

ix. Njësia e qeverisjes vendore që administron zonën ku zbatohet projekti.

Njësia e qeverisjes vendore që administron zonën ku zbatohet projekti, është Propisht, nën administrimin e së cilës gjenden fshatrat Fshatrat; Proptisht, Rodokal Sipër, Rodokal Poshtë, Homezh, Slabinjë, Somotinë, Kriçkovë, Selcë e Poshtme, Homçan, Vërri, Golik, Slatinë, Baribardhë, Selishtë, Zalltore

x. Vlerësimi i ndikimeve në mjedis.

Proçesi i vlerësimit të ndikimeve negative në mjediset e vendeve të punës dhe në zonën rreth tyre, është i lidhur me kryerjen e një sërë njohjesh dhe vlerësimesh të tilla si:

- Njohja e vlerave natyrore dhe mjedisore të zonës si dhe të truallit/tokës që shfrytëzohet.
- Njohja me infrastrukturën inxhinjerie egzistuese dhe me nevojën për plotësim të saj me infrastrukturë të re, apo të modifikuar në plotësim të kërkesave që parashtron projekti që zbatohet.
- Njohja me lëndët e para dhe ato ndihmëse si dhe me energjitë e nevojshme që përdoren për zbatimin e projektit.

Mbështetur mbi këto të dhëna bazë si dhe, në treguesit mjedisor të subjektit të reflektuara gjatë punës së tij, ekspertë të subjektit bënë përpjekje për të përcaktuar vlerësimet e identifikuar në mjedis. Vlerësim ka të bëjë me efektet e tyre të drejtpërdrejta apo të tërthorta në treguesit cilësor të mjedisit, në zonën ku zhvillohet projekti dhe është një nga fazat më të rëndësishme për zbatuesit e projektit sepse:

- Tregon llojin, elementët dhe kohë zgjatjen e çdo lloji ndikimi të identifikuar.
- Përafrohet ato me objektivitet me tërësinë e bashkëveprimeve të tyre me parametrat mjedisor të zonës ku zhvillohet projekti.

Kriteret e përdorur për vlerësimin e ndikimeve variojnë dhe përcaktohen nga faktorë të përcaktuar dhe, rezultatet e arritura drejtohen kryesisht drejtë përmirësimeve më të mundshme të treguesve të ndikuar të mjedisit.

Shtrirja fizike e ndikimeve negative.

Ky parametër vlerëson sipërfaqen apo dimensionet hapësirë të shtrirjes së një ndikimi të vlerësuar në raport me burimin që gjeneron këtë ndikim. Duke vlerësuar llojet e elementëve ndotës të shkarkuar në mjediset e vendeve të punës, sasitë respektive të tyre si dhe drejtimin e erërave, gjykojmë se kemi të bëjmë me një shtrirje të kufizuar të përhapjes së tyre.

Kohëzgjatja e ndikimeve negative.

Ky parametër vlerëson periudhën kohore se sa mund të zgjasë një ndikim i caktuar në dimensionin kohor dhe kështu mund të kemi ndikim të përhershëm/mbetës apo ndikim të përkohshëm.

PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

Pothuajse të gjithë ndikimet negative në mjedis si psh shkarkimi i gazeve, zhurmave etj. janë ndikime të përkoshëme. Gjenerimi i elementëve ndotës në mjediset e vendeve të punës, ndërpritet sapo ndërpritet apo ndalon puna e pajisjeve e makinerive që i gjenerojnë ato. Një tjetër element i përkohshmërisë është edhe, zhvillimi i kësaj veprimtarije vetëm në një periudhë 8 orë në ditë, zakonisht paradite dhe, ndërpreja e saj në ditët e pushimeve zyrtare përfshi këtu të shtunat e të djelat.

Kthyeshmëria

Ky parametër vlerëson të gjitha mundësitë e kthimit të mjedisit të ndikuar, në gjendjen e tij të mëparëshme apo/ose aftësitë për rehabilitimin dhe regjenerimin e plotë të mjedisit të ndikuar.

Rëndësia.

Ky parametër realizon një vlerësim total të të gjithë përmasave të mësipërm dhe njëkohësisht thekson e rekomandon drejtimet më të rëndësishme që duhet ndjekur dhe zbatuar nga drejtuesit e subjektit, për të administruar saktësisht çdo lloj ndikimi të identifikuar.

Llojet e ndikimeve të identifikuara (direkte dhe jodirekte).

Ndikimet e identifikuara nga zhvillimi i aktivitetit të prodhimit të betonit janë ndikime të drejtpërdrejta në mjedis.

Vlerësimi i Ndikimit të Shkarkimeve në Ajër

Ndotja e ajrit është një përzierje komplekse me shumë komponentë toksikë që rrjedhin nga djegia e lëndëve djegëse fosile për transportin, prodhimin e energjisë dhe, aktivitete të tjera njerëzore. Nuk është vetëm sasia totale e lëndëve ndotëse që gjenerohen të cilat merren parasysh, por edhe përbërja e tyre kimike, si p.sh, riaktivizimi i tyre dhe shpërndarja kohore dhe hapësinore (AKM).

Në rastin tonë, të zhvillimit të veprimtarisë të prodhimit të markave të ndryshme betoni, kemi shkarkim të gazeve që kanë në përbërje të tyre bioksid të squfurit (SO₂), monoksid karboni (CO), gaz karbonik (CO₂), oksid të azotit dhe komponime të tjera të tij (NO_x), përbërës të tjerë të avullueshëm etj. Burimi i shkarkimit të këtyre gazeve është puna e motorëve të mjeteve ngarkuese e transportuese të lëndëve të para dhe produktit, që punojnë me lëndë djegëse kryesisht me naftë.

Këto shkarkime janë të përkohëshme, e vlerësuar kjo në periudhën ditore të shkarkimit (rreth 4-5 orë/ditë) si dhe në periudhën vjetore (max 175 ditë pune në një vit kalendarik). Janë gaze lehtësisht “të tretshëm” në ajrin/atmosferën e vendit ku ato gjenerojnë dhe, kanë mundësi të pakta të shpërndarjes së tyre nga vendi i gjenerimit.

PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

Krahas shkarkimit të gazeve, kemi edhe shkarkim të pluhurit gjatë zhvillimit të proceseve të ngarkim/shkarkimit të inerteve, çimentos etj, lëvizjes së mjeteve ngarkuese dhe çvendosëse të material brenda objektit si dhe të mjeteve transportuese.

Grimcat e imta kanë impakt në shëndet edhe kur janë në përqendrim të ulta megjithëse ende nuk është identifikuar saktë kufiri/niveli i përqendrimit të tyre, në të cilin ka efekt shëndetësor dhe jo

Periodiciteti dhe kohëzgjatja e shkarkimit të pluhurit vlerësohet i ngjashëm me atë të shkarkimit të gazeve, si element që gjenerohen nga apo gjatë zhvillimit të të njëjtëve operacione pune.

VLERËSIMI I NDIKIMIT NË UJËRAT SIPËRFAQËSORË.

Për të kryer vlerësimin e ndikimit në ujërat sipërfaqësorë, duhet respektuar kuadri ligjor në fuqi, për:

- Substancat e rrezikshme dhe të dëmshme të shkarkuara në ujë, si dhe klasifikimi kombëtar i mjediseve ujore dhe ujërave bregdetare;
 - Kushtet për shkarkimin e ujërave të ndotura në kanalizimet publike;
 - Kushtet për shkarkimin e ujërave të ndotura në ujërat sipërfaqësorë;
 - Klasifikimi i ujërave dhe rrjedhave ujore.

Ndotja e ujërave sipërfaqësorë shkaktohet nga shkarkimi i ujërave të mbetura të patrajtuara. Shkarkimet urbane, të zonave industriale ekzistuese, komplekseve të dikurshme industriale dhe atyre të nxjerrjes dhe përpunimit të mineraleve, tregojnë për një ndikim të dukshëm dhe të qëndrueshëm të shkarkimeve të ujërave të gjeneruar prej tyre, në cilësinë e ujërave të lumenjëve dhe liqeneve.

Ujërat sipërfaqësorë që gjenden në afërsi të kësaj veprimtarije ndoten përgjithësisht nga ujërat e qendrave të banuara si dhe nga ujërat e kulluara nga tokat bujqësore, mbjelljet e të cilave janë trajtuar me pesticide etj. për lumi Shkumbin janë këto të dhëna zyrtare:

- Prurja mesatare shumëvjeçare e aluvioneve pezull është 187 kg/sek,
- turbullira 3040gr/m².
- mineralizimi është 317mg/litër dhe përbëhet kryesisht nga bikarbonate.

Ujërat sipërfaqësorë që dalin nga kjo veprimtari, ndoten me pluhur që ato marrin me vete gjatë rrjedhjes në sheshet e punës së saj. Niveli i përqendrimit të elementëve pezull në këto ujëra është relativisht i ulët dhe duke vlerësuar edhe sasinë e reshjeve, mund të pohohet se ka një influencë minimale në shkallën e ndotjes së ujërave sipërfaqësorë të zonës.

PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

PËRSHKRIMI I IMPJANTIT DHE VEPRIMTARISË.

Veprimtaria e Subjektit "Victoria Invest" sh.p.k. konsiston në zhvillimin e aktivitetit të prodhimit të betonit në fabrikën apo linjën teknologjike të prodhimit të betonit.

i. *Linja e prodhimit të betonit* përbëhet nga:

- Pulti i komandimit të linjës teknologjike.
- Silloz çimentoje me vëllim 45 m³.
- Bunkeri i inerteve me vëllim 100 m³
- Peshore e çimentos dhe e inerteve.
- Transportjeri i inerteve.
- Transportjeri i çimentos.
- Mikseri ku përgatiten betonet e markave të caktuara.
- Pajisja ku ngarkohen mjetet e transportit të betonit.



Me termin beton në rastin e përgjithshëm shënohen materialet ndërtimore të përbëra nga agregati / mbushësit (rëra me zhavorrin ose çakalli), mjetit lidhës dhe ujit dhe në disa raste të caktuara dhe shtesa speciale - aditivë.

Prodhimi i betonit është një operacion pune i njohur dhe relativisht i thjeshtë sepse ka të bëjë me përzierjen e tre elementëve përbërs të tij që janë inertet, çimentoja dhe uji.

Në raste të veçanta, mund të përdoren edhe shtesa për përmirësimin e cilësisë së kërkuar të një marke betoni.

PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

Vetitë apo treguesit cilësor të betonit varen dhe përcaktohen nga të gjithë lëndët përbërëse të tij, nga lloji dhe sasia si dhe, treguesit cilësor të tyre. Po kështu treguesit cilësor të betonit janë të kondicionuar edhe nga kushtet e transportit, vendosja-shtruarja si dhe kujdesi për betonin.

Në varësi nga masa vëllimore / kubike e realizuar, betoni ndahet në:

- ❖ **betone të lehta** - me masë vëllimore më të vogël se 1800 kg/m^3 ;
- ❖ **betone të thjeshta (normale)** – me masë vëllimore $1800 - 2500 \text{ kg/m}^3$;
- ❖ **betonet e rënda** - me masë vëllimore më të madhe se 2500 kg/m^3 ;

Kjo linjë teknologjike prodhon kryesisht betone të thjeshta – normale të cilët paraqesin një nga materialet themelore të ndërtimit dhe kanë zbatim më të madh në praktikën e përditëshme. Për prodhimin e këtij lloj betoni, si lëndë lidhëse shfrytëzohet çimento, si agregat mbushës –inerte të nxjerra nga shtrati i lumit ose inerte të gurit si dhe uji.

Betoni si material ndërtimor veçohet me qëndrueshmëri të lartë ndaj shtypjes dhe qëndrueshmëri të vogël ndaj tërheqjes. Për shkak të këtyre vetive ai mund të përdoret për realizimin e konstruksioneve në të cilat mbizotërojnë tensionet apo forcat në shtypje siç janë: themele, disa lloje të mureve mbështetëse dhe shtylla, blloqe për muratim etj.

Në elementet ndërtimorë në të cilët paraqiten apo mbizotërojnë edhe tensionet apo forcat në tërheqje që janë edhe rastet më të shpeshtë në praktikë, në këto element ndërtimorë vendosen shufra prej çeliku (armaturë). Kështu, elementet ndërtimorë prej betonit të përforcuara/armuara mund të pranojnë/durojnë ngarkesa dhjetë herë më të mëdha. Materiali i cili fitohet me gërshetim të betonit dhe armaturës metalike quhet **beton i armuar** dhe prej tij mund të realizohen konstruksione të objekteve nga ndërtimi i lartë, objekte hidroteknike, ura, tunele, silose etj.

Linja teknologjike e prodhimit të betonit, do të vihet në punë sa herë që ka kërkesa për betone të markave të ndryshme. Është një eksperiencë relativisht e vogël pune e shfrytëzimit e kësaj linje teknologjike dhe, për rrjedhojë nuk mund të dëshmohet për ditë të punuar gjatë një viti kalendarik. Pajisjet e instaluara në përbërje të kësaj linje teknologjike janë të afta të arrijnë një prodhimtari betoni prej rreth 80 ton/orë.

Është një linjë e cila punon tërësisht e automatizuar, në bazë të programeve të instaluara në panelin/pultin e tij të komandimit.

Granili me një përbërje granulometrike të caktuar (raporti sasior i përmbajtjes së madhësive të caktuara kokrrizash të lëndës inerte) është i vendosur në depozitën përkatëse të impjantit. Ai merret me mjetet e transportit të vetë subjektit nga sheshi i stokimit që gjendet pranë impjantit dhe ngarkohet në bunkerin përkatës.

Po kështu edhe çimentoja e një marke të caktuar është vendosur në sillozin përkatës. Nëpërmjet pultit të komandimit përcaktohen sasitë respektive të inertit, çimentos dhe uji të cilët dërgohen në përzjerësin mekanik të tyre (mikserin). Këtu bëhet përzjerja homogjenizuese e të tre këtyre lëndëve për disa minuta dhe pas kësaj, ngarkesa e pregatitur

PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

shkon në makinën transportues, e cila gjatë lëvizjes për në destinacion vijon të përzejë betonin e përgatitur.

ii. Ngarkimi dhe transporti i brendëshëm.

Ngarkimi dhe transporti i brendëshëm në këtë veprimtari janë dy prej proceseve teknologjike kryesorë. Këtyre dy proceseve ju nënshtrohen të gjitha llojet e lëndëve/materialeve të cilat përdoren si lëndë e parë të tilla si inertet, çimentoja etj. dhe njëkohësisht edhe prodhimet e kësaj veprimtarie si betoni etj.

Lëndët e para sillen në objekt kryesisht me mjete transporti, të vetë subjektit i cili është i liçensuar për prodhimin dhe transportin e inerteve, çimentos etj.

Transporti i betonit nga linja e prodhimit të tij, në vendin ku ai do të përdoret kryhet me automjet të specializuar për këtë qëllim, në pronësi të vetë subjektit VIKTORIA INVEST. Ngarkimi i automjetit bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga linja teknologjike e prodhimit të betonit.

Brenda teritorit të objektit gjendet edhe një shesh i sistemuar i cili shërben për parkimin e mjeteve që punojnë në këtë veprimtari.

Menaxhimi i mbetjeve të ngurta.

Zhvillimi i proceseve të prodhimit të betonit në raste specifike, krijon shkarkime të mbetjeve të ngurta të cilat përbëhen kryesisht prej inerteve, çimentos etj. Të gjitha këto lëndë nuk klasifikohen tek lëndë të rrezikëshme, sipas legjislacionit aktual të vendit tonë. Këto mbetje teknologjike qëndrojnë përkohësisht në vende të caktuara për to, deri në momentin e ripërdorimit në procesin teknologjik të prodhimit të një marke të caktuar betoni. Treguesit cilësor të lëndëve apo materialeve që përbëjnë mbetjet teknologjike, koha e kufizuar e qëndrimit të tyre në vendepozitim të përkohëshëm, japin impakte minimale në tokë, në vendin e ku ato qëndrojnë.

Veprimtari e prodhimit të betonit dhe të tjera veprimtari që zhvillon ky subjekt në këtë teritor, shoqërohen edhe me krijimin e mbetjeve të ngurta urbane, të cilat përbëhen kryesisht prej ambalazheve të letrës e kartonit, plastikës, metalit etj.

Në një vend të caktuar, të shtruar me beton, janë vendosur kazanët e mbledheve të mbetjeve urbane të krijuar gjatë zhvillimit të kësaj veprimtarie. Këto mbetje largohen çdo ditë, nga ky vend duke u hedhur në kazanët e mbetjeve urbane të fshatit. Kështu që influenca e këtyre mbetjeve në cilësinë e tokës është minimale për të mos thënë që nuk egziston.

Në katalogun shqiptar të klasifikimit të mbetjeve të ngurta, V.K.M.-së Nr. 99, datë 18.02.2005 "PËR MIRATIMIN E KATALOGUT SHQIPTAR TË KLASIFIKIMIT TË MBETJEVE", nuk përfshihet veprimtari e prodhimit të betonit dhe mbetjet e gjeneruara gjatë zhvillimit të saj. Duke vlerësuar të gjitha kategorizimet e mbetjeve të ngurta, të përcaktuara në këtë VKM, dhe llojet e mbetjeve të ngurta të gjeneruara gjatë procesit të prodhimit të betonit, në vijim po japim të dhënat respektive:

PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

01	MBETJE QË DALIN NGA KËRKIMET E SHFRYTËZIMI I MINIERAVE DHE KARRIERAVE, SI EDHE NGA TRAJTIMET FIZIKO - KIMIKE TË MINERALEVE.
01 03 08	Mbetje pluhurash, përveç atyre të përmendura në rubrikën 01 03 07
01 04 08	Mbetje zhavorri dhe mbetje gurësh të tjera nga ato të përmendura në 01 03 07
01 04 09	Mbetje rërash dhe argjilash
01 04 10	Mbetje pluhurash, të tjera nga ato të përmendura në 01 04 07

Menaxhimi i mbetjeve të lëngshme.

Këtu kemi, shkarkime të ujrave sipërfaqësore gjatë reshjeve të shiut si dhe shkarkime të rastësishme të ujrave gjatë proceseve të ndryshme pune. Këto ujra mbartin me vete ngrimca të ngurta të inerteve si dhe çimento. “Ndotja” e ujrave sipërfaqësore mund të ndodhë nga:

- a) Pastrimi i ambientit ku është instaluar impjanti i prodhimit të betonit, në rastet e shkarkimit të materialeve që përpunohen aty, nga avari të ndryshme teknike,
- b) Ujrat e përdorura për qëllime sanitare.

Ujrat derdhen në një vaskë dekantuese dhe më tej në ujrat e lumit Shkumbin, i cili rrjedh disa metra larg kufirit jug-perëndimor të objektit.

Në këtë zonë rurale nuk ka rrjet të kanalizimeve për shkarkimin e ujrave të zeza. Kështuqë, ujrat që dalin nga ambientet hidro-sanitare dhe që përmbajnë ujra të zeza shkarkohen në gropa septike.

